



Elida Trusheaj  
Ety



T. Xano Skuf  
Ysida Monopati Skuf  
Artemida Duceji fucej

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE  
REKTORATI

Nr. 878 / Prot.

12

Vlorë, më 26.04.2023

VENDIM

Nr. 5 datë 24.04.2023

PËR

**MIRATIMIN REKOMANDIMEVE MBËSHTETUR NË REZULTATET E PYETËSORIT TË STUDENTËVE PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË MËSIMDHËNIES NË LËNDËT E ÇDO PROGRAM STUDIMI PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022.**

Mbështetur në nenin 40 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenin 26 të Statutit të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, në shkresën e Zv. Rektorit për Kërkim Shkencor dhe Zhvillim Institucional, Nr.830., prot datë 19.04.2023, Rektorati në mbledhjen e tij të dates 24.04.2023,


VENDOSI

1. Të miratojë Rekomandimet mbështetur në Rezultatet e Pyetësorit të Studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies në lëndët e çdo program studimi për Vitin Akademik 2021-2022.(Bashkëlidhur materiali përkatës).
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi: Njësitë Kryesore, Njësitë Bazë, Zëvendësrektorit për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Insitucional, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm Cilësisë dhe Projekteve dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Roland ZISI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

Nr. 830 Prot.

Vlorë, më 13/12/2023

**Lënda:** Kthim përgjigje për ngritjen e grupit të punës mbi hartimin e rekomandimeve mbështetur në rezultatet e pyetësorit të studentëve

**PROF. DR. ROLAND ZISI**  
**REKTOR**

**KËTU:**

I nderuar zoti Rektor,

Në kuadër të urdhërit Nr. 112 datë 10.11.2022 "Për ngritjen e grupit të punës mbi hartimin e rekomandimeve mbështetur në rezultatet e pyetësorit të studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies në lëndët e çdo program studimi për vitin akademik 2021-2022" ju lutem gjeni bashkëlidhur draft rekomandimet e hartuara nga grupi i punës.

Ju faleminderit për bashkpunimin!

Zv. Rektor

Prof. Asoc. Enkelejd Mëhilli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITY OF VLORA 'ISMAIL QEMALI'  
KOMISION AD-HOC

Nr. .... Prot.

Vlorë, më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2023

**Lënda:** Raport mbi hartimin e rekomandimeve mbështetur në rezultatet e pyetësorit të studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies në lëndët e çdo program studimi për vitin akademik 2021-2022

**KËTU:**

**PROF. DR. ROLAND ZISI**

**REKTOR**

Në përgjigje të Urdhërit Nr. 112 datë 10.11.2022 me Nr. 1708 Prot. Datë 10/11/2022, "Për Ngritjen e grupit të punës mbi hartimin e rekomandimeve mbështetur në rezultatet e pyetësorit të studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies në lëndët e çdo program studimi për vitin akademik 2021-2022, Ju lutem gjeni bashkëlidhur rekomandimet e hartuara nga grupi i punës.

**Në bazë të rezultateve, në të 4 Fakultetet mund të konkludojm se:**

1. Pjesëmarrja në plotësimin e pyetësorit është në një nivel rreth 80%;
2. Në një nivel mbi 75% studentët raportojnë se leksionet ishin të strukturuar dhe organizuara mirë;
3. Në një nivel të lart studentët raportojnë se matërialet e leksioneve ishin të qarta dhe përmirësuan të nxënin;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITY OF VLORA 'ISMAIL QEMALI'  
KOMISION AD-HOC

4. Në një nivel mbi 75% studentët raportojnë se pedagogët transmetonin idetë dhe konceptet në mënyrë të qartë;
5. Në një nivel mbi 85% studentët raportojnë se janë plotësisht dakord / dakord se pedagogët nxisin dialogun/diskutimin në auditor si dhe nxisin mendimin kritik duke bërë lëndën interesante;
6. Studentët raportojnë se në përqindje shumë të lart se pedagogët japin sqarime dhe janë të gatshëm vazhdimisht të ndihmojnë studentët në raste që ata kanë pyetje/paqtësi;
7. Në një nivel të lart studentët raportojnë se pedagogët krijojnë klimë të përshtatshme në zhvillimin e ideve të reja nisur nga studimet e ndryshme kërkimore-shkencore dhe se i mbështesin ata në zhvillimin e ideve të reja;
8. Në një nivel më të lart se 80% studentët raportojnë se janë plotësisht dakord/dakord se pedagogët kanë qenë objektiv dhe të drejtë në korrigjimin dhe vlerësimin e njohurive.
9. Studentët në nivel mbi 80% janë të kënaqur me eksperiencën e tyre në modulet e zhvilluara.

**Propozime për përmirësim të situatës në bazë të pyetjeve kualitative dhe kuantitative:**

- Rritje të pjesmarrjes së studentëve në një nivel mbi 90% në plotësimin e pyetësorit;
- Rritja e pjesmarrjes aktive të studentëve në leksione me qëllim mendimin kritik dhe dialogun në klasë;
- Të gjithë pedagogët të venë në dispozicion të studentëve syllabusin e lëndës;
- Mbështetje më e madhe e studentëve mbi zhvillimin e ideve inovative dhe krijuese;
- Në rastet kur pedagogët ofrojnë matëriale ekstra, do ishte mirë që tu ofrohen studentëve në kohë;
- Në disa programe studimi propozohet që pedagogët tu ofrojnë studentëve pikat kryesore si dhe tu vëri në pah çështjet e rëndësishme;
- Përmirësimi i bazës matëriale me qëllim zhvillimin e leksioneve me kushtet bashkëkohore;
- Në disa leksione propozohet që të jepen detyra në grup me qëllim punën e studentëve në grup. Kjo rrit aftësitë bashkëpunuese të studentëve;
- Mirëstrukturimi dhe mirëorganizimi i leksioneve seminareve me literaturë bashkëkohore;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITY OF VLORA 'ISMAIL QEMALI'  
KOMISION AD-HOC

- Përmirësimi i aftësive mësimdhënëse të pedagogëve duke u fokusuar në metodologji mësimdhënëse inovative;
- Pedagogët duhet të përfshinë orare konsultimi me studentët për çështje të ndryshme rreth leksioneve;
- Në tezën e paraqitur për miratim nga Drejtuesi i Departamentit, pedagogët duhet të përfshinë dhe vlerësimin për secilën nga pyetjet;
- Rritja e orëve të praktikave në disa module;
- Përmirësimi i mësimdhënies me prezantimin e rasteve dhe shëmbujve konkret dhe mos fokusimi në nivele të larta në teori;
- Përmirësimi i literaturës së disponueshme për lëndët e programeve të studimit në bibliotekën e Universitetit;
- Përdorimi i metodave interaktive në mësimdhënie;
- Pas korrigjimit të provimeve, tu jepet mundësia studentëve të shikojnë tezën duke iu sqaruar atyre gabimet e bëra;
- Mungesa e literaturës bazë në disa module;
- Mungesa e korrektesës së pedagogëve në orarin e planifikuar për zhvillimin e mësimin në disa lëndë;
- Mos zhvillimi i leksioneve/seminareve nga disa pedagogë sipas programit të miratuar;
- Përmirësimi i kapaciteteve infrastrukturore të Universitetit me qëllim hapsira më të mëdha për zhvillimin e leksioneve/seminareve;
- Zhvillimi i leksioneve dhe seminareve të zhvillohet nga i njëjti pedagog dhe jo nga të ndryshëm pasi kjo çorjenton studentët;
- Mungesa e disa software me qëllim zhvillimin e leksioneve/seminareve në bazë të situatave reale;
- Mungesa e literaturës në gjuhën shqipe;
- Përmirësimi i procesit të praktikave me qëllim përmirësimi i njohurive dhe aftësive të studentëve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITY OF VLORA 'ISMAIL QEMALI'  
KOMISION AD-HOC

Plan veprimi:

Objektivi specifik	Aktiviteti	Strukturat përgjegjëse	Burimet
Rritje të pjesmarrjes së studentëve në një nivel mbi 90% në plotësimin e pyetësorit;	Informim i studentëve rregullisht mbi plotësimin e pyetësorit;  Informim i studentëve para provimit mbi plotësimin e pyetësorit.	Njësitë Bazë NJSBC	Burime njerëzore
Rritja e pjesmarrjes aktive të studentëve në leksione me qëllim mendimin kritik dhe dialogun në klasë	Inkurajimi nga pedagogët për pjesmarrje aktive të studentëve në leksione;  Trajnim i vazhdueshëm i pedagogëve për angazhim më të lart të studentëve gjatë leksioneve.	Senati akademik Bordi i Administrimit Njësitë Kryesore Njësitë Bazë	Burime njerëzore Burime financiare
Të gjithë pedagogët të venë në dispozicion të studentëve syllabusin e lëndës;	Në fillim të secilit modul pedagogu i lëndës tu prezantoj syllabusin studentëve.	Njësitë Bazë	Burime njerëzore
Mbështetje më e madhe e studentëve mbi zhvillimin e ideve inovative dhe krijuese;	Inkurajim i studentëve për të prezantuar ide inovative të tyre  Parashikimi në buxhet i një fondi specifik për financimin e ideve inovative të studentëve;  Pjesmarrje më aktive e studentëve në HUB-et ndërtuara në Universitet;	Senati akademik Bordi i Administrimit Njësitë Kryesore Njësitë Bazë	Burime njerëzore Burime financiare
Në rastet kur pedagogët ofrojnë materiale ekstra, do ishte mirë që tu ofrohen studentëve në kohë;	Ofrimi i materialeve në kohë nga pedagogët	Njësitë Bazë	Burime njerëzore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITY OF VLORA 'ISMAIL QEMALI'  
KOMISION AD-HOC

Në disa programe studimi propozohet që pedaogogët tu ofrojnë studentëve pikat kryesore si dhe tu vëri në pah çështjet e rëndësishme;	Zhvillimi i leksioneve konsultuese në fund të semestrit akademik	Njësia Bazë	Burime njerëzore
Përmirësimi i bazës materiale me qëllim zhvillimin e leksioneve me kushtet bashkëkohore;	Parashikimi në buxhet për përmirësimin e bazës materiale	Senati akademik Bordi i Administrimit Njësitë Kryesore Njësitë Bazë	Burime njerëzore Burime financiare
Në disa leksione propozohet që të jepen detyra në grup me qëllim punën e studentëve në grup. Kjo rrit aftësitë bashkëpunuese të studentëve;	Parashikimi në syllabuse për punë në grup (detyrë kursi në grup) të studentëve;	Njësitë Bazë	Burime njerëzore
Mirëstrukturimi dhe mirëorganizimi i leksioneve seminareve me literaturë bashkëkohore;	Parashikimi në buxhet i fondeve specifike për literaturë bashkëkohore;  Përdorim më i lart i pedagogëve dhe studentëve të bibliotekave on-line.	Senati akademik Bordi i Administrimit Njësitë Kryesore Njësitë Bazë	Burime njerëzore Burime financiare
Përmirësimi i aftësive mësimdhënëse të pedagogëve duke u fokusuar në metodologji mësimdhënëse inovative;	Trajnim i pedagogëve për mësimdhënie inovative;	Senati akademik Bordi i Administrimit Njësitë Kryesore Njësitë Bazë	Burime njerëzore Burime financiare
Pedagogët duhet të përfshinë orare konsultimi me studentët për çështje të ndryshme rreth leksioneve;	Planifikimi i orareve të konsultimit gjatë semestrit si dhe në fund të modulit;	Njësitë Bazë	Burime njerëzore
Në tezën e paraqitur për miratim nga Drejtuesi i Departamentit,	Parashikimi i pikëve për secilën pyetje në tezën e provimit	Njësitë Bazë	Burime njerëzore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITY OF VLORA 'ISMAIL QEMALI'  
KOMISION AD-HOC

pedagogët duhet të përfshin dhe vlerësimin për secilën nga pyetjet;			
Rritja e orëve të praktikave në disa module;	Ndryshimie brenda 20% me qëllim rritjen e orëve të praktikës	Senati Akademik Njësia Kryesore Njësia Bazë Bordi i Administrimit	Burime njerëzore Burime financiare
Përmirësimi i mësimdhënies me prezantimin e rasteve dhe shëmbujve konkret dhe mos fokusimi në nivele të larta në teori;	Zhvillimi i mësimëve në mënyrë interaktive;  Përfshirja në mësimdhënie e stakeholders-ave me të cilët universiteti bashkëpunon	Njësia Kryesore Njësia Bazë Bordi i Administrimit	Burime njerëzore Burime financiare
Përmirësimi i literaturës së disponueshme për lëndët e programeve të studimit në bibliotekën e Universitetit;	Parashikimi në buxhet i fondeve specifike për literaturë bashkëkohore;  Përdorim më i lart i pedagogëve dhe studentëve të bibliotekave on-line.	Senati akademik Bordi i Administrimit Njësitë Kryesore Njësitë Bazë	Burime njerëzore Burime financiare
Përdorimi i metodave interaktive në mësimdhënie;	Parashikimi në buxhet i fondeve specifike për përmirësimin e infrastrukturës së Institucionit;  Trajnimi i pedagogëve në metoda inovative të mësimdhënies.	Senati akademik Bordi i Administrimit Njësitë Kryesore Njësitë Bazë	Burime njerëzore Burime financiare
Pas korigjimit të provimeve, tu jepet mundësia studentëve të shikojnë tezën duke iu sqaruar atyre gabimet e bëra;	Parashikimi nga pedagogët i orareve specifike mbi sqarimin e studentëve për rezultatet e provimit	Njësitë Bazë	Burime Njerëzore
Mungesa e literaturës bazë në disa module;	Parashikimi në buxhet i fondeve specifike për literaturë bashkëkohore;  Përdorim më i lart i pedagogëve dhe	Senati akademik Bordi i Administrimit Njësitë Kryesore Njësitë Bazë	Burime njerëzore Burime financiare





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITY OF VLORA 'ISMAIL QEMALI'  
KOMISION AD-HOC

	studentëve të bibliotekave on-line.		
Mungesa e korrektesës së pedagogëve në orarin e planifikuar për zhvillimin e mësimin në disa lëndë;	Kontrolle të vazhdueshme nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore dhe Bazë mbi respektimin e orarit nga pedagogët	Njësiti Kryesore Njësiti Bazë	Burime njerëzore
Mos zhvillimi i leksioneve/seminareve nga disa pedagogë sipas programit të miratuar;	Kontrolle të vazhdueshme nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore dhe Bazë mbi zhvillimin e leksioneve nga pedagogët	Njësiti Kryesore Njësiti Bazë	Burime njerëzore
Përmirësimi i kapaciteteve infrastrukturore të Universitetit me qëllim hapsira më të mëdha për zhvillimin e leksioneve/seminareve;	Parashikimi në buxhet i fondeve specifike për përmirësimin e infrastrukturës së Institucionit;	Senati akademik Bordi i Administrimit Njësiti Kryesore Njësiti Bazë	Burime njerëzore Burime financiare
Zhvillimi i leksioneve dhe seminareve nga i njëjti pedagog dhe jo nga të ndryshëm pasi kjo çorjenton studentët;	Parashikimi në orar në bazë të mundësive i zhvillimit të leksioneve dhe seminareve nga i njëjti pedagog	Njësiti Bazë	Burime njerëzore
Mungesa e disa software me qëllim zhvillimin e leksioneve/seminareve në bazë të situatave reale;	Parashikimi në buxhet i fondeve specifike për përmirësimin e infrastrukturës së Institucionit;	Senati akademik Bordi i Administrimit Njësiti Kryesore Njësiti Bazë	Burime njerëzore Burime financiare
Mungesa e literaturës në gjuhën shqipe;	Parashikimi në buxhet i fondeve specifike për përmirësimin e literaturës së përdorur;  Bashkëpunim më i ngushtë i Institucionit me AADF në kuadër të projektit CleanScore ku parashikohen dhe përkthim librash.	Senati akademik Bordi i Administrimit Njësiti Kryesore Njësiti Bazë	Burime njerëzore Burime financiare



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITY OF VLORA 'ISMAIL QEMALI'  
KOMISION AD-HOC

Përmirësimi i procesit të praktikave me qëllim përmirësimi i njohurive dhe aftësive të studentëve.	Pjesmarrje më aktive e studentëve në praktikat mësimore;	Njësitë Bazë	Burime njerëzore
--	--	--------------	------------------

**Grupi i punës**

Prof. Asoc. Enkelejd Mëhilli

Prof. Asoc. Frosina Londo

Prof. Asoc. Denada Sota

Dr. Amalia Çipi

M. - 2004  
E. Mëhilli

Dr. Oljana Hoxha

Dr. Rezarta Lalo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
REKTORI

Vlorë më, 19.04.2023

Lënda : Ngarkohen për zbatimin e shkresës bashkëlidhur në respektim të legjislacionit përkatës në fuqi :

Drejtuar:

- Senati ✓
- Rektorati ✓
- Këshilli Etikës
- Rektori
  - Qendra Studimore e Zhvillimit Rajonal
  - Sektori Juridik
  - Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore
    - Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës
    - Sektori i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun
    - Sektori i IT-së
- Bordi i Administrimit
- Administrator
  - Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
  - Sektori i Financës dhe Realizimit të Buxhetit
  - Sektori i Prokurimeve
  - Sektori i Shërbimeve
- Njësia e Auditit të Brendshëm
- Zv. Rektor për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Insitucional
  - Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve
  - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional
  - Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë
- Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Promovimit Akademik
- Zv. Rektor Akademik
  - Drejtoria e Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë
  - Sektori i Kurikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve
  - Sektori i Këshillimit të Karrierës Alumni dhe Aktiviteteve Kulturore Sportive
- Sektori i Bibliotekes Shkencore
  
- Prof. Asoc. Aurela Saliaj      Dekan F.SH.
  - Kryesekretare              F.SH.
- Prof. Dr. Albert Qarri        Dekan F.E.
  - Kryesekretare              F.E
- Prof. As. Armela Panajoti    Dekan F.SH.H.D.
  - Kryesekretare              F.SH.H.D
- Prof.As. Hajdar Kicaj        Dekan F.SH.T.N.
  - Kryesekretare              F.SH.T.N

REKTORI  
Prof. Dr. Roland ZISI